



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 211, Datë 27.09.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BE-IS ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “KALIVARË 1” ME FUQI TE INSTALUAR 578 KW, “KALIVARË 2” ME FUQI TE INSTALUAR 1234 KW, “KALIVARË 3” ME FUQI TE INSTALUAR 1653 KW, DHE “KALIVARË 4” ME FUQI TE INSTALUAR 1998KW, ME FUQI TOTALE 5463 KW, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË PUKË

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a”; nenit 10, pika 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 27.09.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “BE-IS Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë nga HEC-et “Kalivarë 1” me fuqi të instaluar 578 kW, “Kalivarë 2” me fuqi të instaluar 1234 kW, “Kalivarë 3” me fuqi të instaluar 1653 kW dhe “Kalivarë 4” me fuqi të instaluar 1998kW, me fuqi totale 5463 kW, me vendndodhje në Bashkinë Pukë

Konstatoi se:

- Shoqëria “BE-IS Energy” shpk, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 580 Prot, datë 06.09.2018, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Kalivarë 1”, “Kalivarë 2”, “Kalivarë 3” dhe “Kalivarë 4”, me vendndodhje në Bashkinë Pukë.
- Aplikimi i shoqërisë “BE-IS Energy” shpk, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1; 4.4.2; 4.4.3; 4.4.4 dhe 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me :

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor:
- Neni 9, pika 2 gërma “f”, (Marrëveshje Koncesioni ose autorizimi nga KM në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës).
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal:
 - Neni 9, pika 3 gërma “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit).
 - Neni 9, pika 3 gërma “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit).

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të paraqesë në ERE dokumentacionin e munguar, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BE – IS Energy” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Kalivar 1” me fuqi të instaluar 578 kW; Hidrocentrali “Kalivar 2” me fuqi të instaluar 1234 kW; Hidrocentrali “Kalivar 3” me fuqi të instaluar 1653 kW; dhe Hidrocentrali “Kalivar 4” me fuqi të instaluar 1998 kW, me fuqi

Totale të instaluar 5463 kW, me vendndodhje në Bashkinë Pukë, për një afat 30(tridhjet) vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI